



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Tiranë, më . 2.2025

Lënda: Raporti i monitorimit të shpenzimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2024.

Ministria e Mbrojtjes administron dhe menaxhon fondet publike, sipas shtatë programeve buxhetore të miratuara, konkretisht:

- 1) Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”;
- 2) Programi “Forcat e Luftimit”;
- 3) Programi “Mbështetja e Luftimit”;
- 4) Programi “Arsimimi Ushtarak”;
- 5) Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”;
- 6) Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”;
- 7) Programi “Emergjencat Civile.

Për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve të buxhetit sipas secilit program, krahasuar me planin me ndryshime të periudhës raportuese, paraqitet, si më poshtë:

Tabela nr. 1

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi i programit	Plani i rishikuar viti 2024	Shpenzime faktike viti 2024	Përqindja
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	2,062,910	1,940,414	94
2.	Forcat e Luftimit	16,180,095	14,698,173	91
3.	Mbështetja e Luftimit	7,409,479	6,767,800	91
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	1,943,726	1,905,423	98
5.	Arsimimi Ushtarak	1,265,332	1,171,873	93
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,243,000	5,243,000	100
7.	Emergjencat Civile	3,007,206	2,354,666	78
	Totali i Shpenzimeve të Ministrisë	37,111,748	34,081,349	92

Niveli i realizimit është masën 92 %, për shkak të mosplotësimit të strukturës organike dhe moskryerjes në kohë të procedurave të prokurimit në shpenzimet kapitale, si dhe mos realizimi i fondeve në artikullin ekonomik 604 “Transfertat Korrente të Brendshme” dhe art. 231 shpenzime “Kapitale të Trupëzuara” nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në llogaritë ekonomike të njërive të vetëqeverisjes vendore, mos realizimi i fondeve është përgjegjësi e tyre. Financimi i Brendshëm është realizuar në masën 81%.

Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët” paraqitet me realizim 100%, programi “Mbështetja për Shëndetësinë” me nivel realizimi 98%, programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” rezulton me realizim 94%, programi “Arsimimi Ushtarak” rezulton me realizim 93%, programi “Forcat e Luftimit” me nivel realizimi 91% dhe programi “Mbështetja e Luftimit” me nivel realizimi 91%, ndërsa me realizim më të ulët janë programi “Emergjencat Civile” me nivel realizimi 78 %.

I. INFORMACION MBI BUXHETIN

Sipas zërave të shpenzimeve buxhetore vetëm me financim të brendshëm, duke përfshirë edhe të ardhurat jashtë limitit, niveli i realizimit është 92 % dhe situata për çdo program për vitin 2024 paraqitet e tillë:

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet, si më poshtë:

- Shpenzime korrente, realizimi është në masën 97%.
- Shpenzime kapitale me Financimi i Brendshëm, realizimi është në masën 81%.
- Shpenzime kapitale me Financim i Huaj, realizimi është në masën 0%,

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime korrente Viti 2024 në %	Shpenzime kapitale të brendshme Viti 2024 në %	Totali i shpenzimeve buxhetore Viti 2024 në %
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	96	69	94
2.	Forcat e Luftimit	98	85	91
3.	Mbështetja e Luftimit	97	60	91
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	100	92	98
5.	Arsimimi Ushtarak	99	81	93
6.	Mbështetje për Ushtarakët	100	0	100
7.	Emergjencat Civile	84	74	78
	TOTALI I MINISTRISË	97	81	92

Për të gjitha programet në nivel ministrie realizimi i **shpenzimeve korrente paraqitet me 97 %**, duke variuar nga më i ulëti programi “Emergjencat Civile” me nivel realizimi 84 %, programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” rezulton me realizim 96%, programi “Mbështetja e Luftimit” me nivel realizimi 97 % programi “Forcat e Luftimit” me nivel realizimi 98%, programi “Arsimimi Ushtarak” rezulton me realizim 99%, deri te programet me nivel realizimi 100% “Mbështetja për Shëndetësinë” dhe “Mbështetje për Ushtarakët”.

Në mosrealizimin në nivelin e planifikimit të shpenzimeve për Ministrinë e Mbrojtjes ka ndikuar mosrealizimi në shpenzime për paga si pasojë e mosplotësimit të strukturave të miratuara në të gjithë programet. Mosrealizimi në nivelin e planifikuar në shpenzime kapitale, si dhe për mallra dhe shërbime ka ardhur si rrjedhojë e zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Në zërin e shpenzimeve kapitale të brendshme, ministria paraqitet me realizim prej 81 % ndaj planit 12-mujor, ku theksojmë se nga ana e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes janë realizuar procedurat e prokurimit sipas projekteve të miratuara, në mos realizim të fondeve në artikullin “Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm” kanë ndikuar transfertat e kryera nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile në llogaritë ekonomike të njërive të vetëqeverisjes vendore, mos realizimi i të cilave është përgjegjësi e tyre, si dhe mos realizimi i procedurave të dërguara te AKSHI.

Duke iu referuar aneksit nr.1 të monitorimit për shpërndarjen e buxhetit ndër 7 programet e ministrisë, më poshtë po paraqesim strukturën e shpenzimeve për çdo program, sipas buxhetit fillestar, buxhetit me ndryshime në nivel vjetor dhe faktit të realizuar gjatë vitit 2024:

Nr.	Emërtimi i programit	Struktura e shpenz. sipas buxhetit fillestar viti 2024 në %	Struktura e shpenz. sipas faktit të vitit 2024 në %
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	3.2	5.7
2.	Forcat e Luftimit	51.6	43.1
3.	Mbështetja e Luftimit	16.6	20
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	3.9	5.6
5.	Arsimimi Ushtarak	2.7	3.4
6.	Mbështetje për Ushtarakët	10.8	15.4
7.	Emergjencat Civile	11.1	7
	Totali i shpenzimeve të Ministrisë	100	100

Shpenzime sipas faktit të vitit 2024 në %, sipas programeve buxhetore të Ministrisë së Mbrojtjes.

Rreth 43% e totalit të shpenzimeve faktike të kryera gjatë vitit 2024, e zë programi “Forcat e Luftimit”, ndjekur nga shpenzimet për programet “Mbështetja e Luftimit” me 20%, “Mbështetje për Ushtarakët” me 15.4%, “Emergjencat Civile” me rreth 7%, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” me 5.7%, “Mbështetja për Shëndetësinë” me 5.6% dhe “Arsimimi Ushtarak” me 3.4%”.

Nga monitorimi konstatohet se struktura e shpenzimeve ndërmjet programeve sipas buxhetit fillestar dhe buxhetit me ndryshime, konstatohen ndryshime në shtatë programe konkretisht:

1. “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 2.3 pikë më e lartë.
2. “Forcat e Luftimit”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 8 pikë më e ulët.
3. “Mbështetja e Luftimit”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 3.4 pikë më e lartë.
4. “Mbështetja për Shëndetësinë”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 1.3 pikë më e lartë.
5. “Arsimimi Ushtarak”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 0.7 pikë më e lartë.
6. “Mbështetje për Ushtarakët”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 3.4 pikë më e lartë.
7. “Emergjencat Civile”, struktura e shpenzimeve të buxhetit të rishikuar në krahasim me strukturën e shpenzimeve të buxhetit fillestar është 3 pikë më e ulët.

Realizimi në vlerë sipas strukturës së tyre për vitin 2024 paraqitet, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i programit	Plani vjetor i rishikur në mijë lekë	Struktura në %	Fakti i vitit 2024	Realizimi në %	Struktura në %
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	2,062,910	6	1,940,414	94	6
2.	Forcat e Luftimit	16,180,095	44	14,698,173	91	43
3.	Mbështetja e Luftimit	7,409,479	20	6,767,800	91	20
4.	Arsimimi Ushtarak	1,943,726	5	1,905,423	98	6

5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,265,332	3	1,171,873	93	3
6.	Mbështetje për Usharakët	5,243,000	14	5,243,000	100	15
7.	Emergjencat Civile	3,007,206	8	2,354,666	78	7
	Totali	37,111,748	100	34,081,349	92	100

Ndryshimet e buxhetit nga plani fillestar deri në planin përfundimtar, në nivel programi dhe artikulli paraqiten, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i programit	Plani fillestar	Plani i rishikuar	Ndryshimi i planit vjetor
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,563,300	2,062,910	499,610
2.	Forcat e Luftimit	24,939,590	16,180,095	(8,759,495)
3.	Mbështetja e Luftimit	8,020,436	7,409,479	(610,957)
4.	Arsimimi Usharak	1,906,000	1,943,726	37,726
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,327,000	1,265,332	(61,668)
6.	Mbështetje për Usharakët	5,200,000	5,243,000	43,000
7.	Emergjencat Civile	5,382,050	3,007,206	(2,374,844)
	TOTALI I MINISTRISË	48,338,376	37,111,748	(11,226,628)

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit të vitit 2024 paraqitet me ulje në vlerën 11,226,628 mijë lekë nga buxheti fillestar ose në masën 23%.

Në ndryshimet e planit të rishikuar të buxhetit në krahasim me planin fillestar.

Këtë ndryshim po e analizojmë sipas artikujve të secilit program:

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Në total për vitin 2024 kemi rritje të buxhetit në shumën 499,610 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601, kemi shtesë fondi në shumën 71,180 mijë lekë, për plotësimin e detyrimeve në këtë artikull, si efekt i rritjes së pagave për ushtarakët.

Në artikullin 602, kemi shtesë fondi në shumën 220,224 mijë lekë shtesë fondi me akt normativ nr. 5, datë 18.10.2023 dhe me akt normativ nr. 6, datë 14.12.2023, për likuidimin e detyrimeve në këtë artikull.

Në artikullin 605, kemi shtesë fondi në shumën 189,896 mijë lekë, për pagesën e kuotizacionit në organizatat ndërkombëtare (NATO).

Në artikullin 606, kemi shtesë fondi në shumën 18,310 mijë lekë, që ka të bëjë me detajimin fillestar të fondit të veçantë për pagesën e ndihmave të menjëhershme dhe kompensime të tjera.

Në artikullin 231 nuk kemi ndryshim fondi.

2. Programi “Forcat e Luftimit”

Në total për vitin 2024 kemi ulje të buxhetit në shumën 8,759,495 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 361,120 mijë lekë.

Në artikullin 602 kemi shtesë fondi në shumën 641,700 mijë lekë.

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 31,495 mijë lekë.

Në artikullin 231 kemi pakësim fondi në shumën 9,793,810 mijë lekë nga të cilat:

Shtesë në investime të brendshme në vlerën 406,190 mijë lekë.

Pakësim në SIFQ i investimeve të huaja në vlerën 10,200,000 mijë lekë.

Nr.	Emërtimi i programit	Plani fillestar	Plani i rishikuar	Ndryshimi i planit vjetor
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	1,563,300	2,062,910	499,610
2.	Forcat e Luftimit	24,939,590	16,180,095	(8,759,495)
3.	Mbështetja e Luftimit	8,020,436	7,409,479	(610,957)
4.	Arsimimi Ushtarak	1,906,000	1,943,726	37,726
5.	Mbështetje për Shëndetësinë	1,327,000	1,265,332	(61,668)
6.	Mbështetje për Ushtarakët	5,200,000	5,243,000	43,000
7.	Emergjencat Civile	5,382,050	3,007,206	(2,374,844)
	TOTALI I MINISTRISË	48,338,376	37,111,748	(11,226,628)

3. Programi “Mbështetja e Luftimit”

Në total për vitin 2024 kemi ulje të buxhetit në shumën 610,958 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 102,993 mijë lekë.

Në artikullin 602 kemi pakësim fondi në shumën 832,049 mijë lekë.

Në artikullin 604 kemi shtesë fondi në shumën 290,000 mijë lekë.

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 28,598 mijë lekë.

Në artikullin 231 kemi pakësim fondi në shumën 200,500 mijë lekë.

4. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Në total për vitin 2024 kemi ulje të buxhetit në shumën 61,668 mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601, kemi pakësim fondi në shumën 130,000 mijë lekë.

Në artikullin 602, kemi shtesë fondi në shumën 16,500 mijë lekë.

Në artikullin 606, kemi shtesë fondi në shumën 67,832 mijë lekë.

Në artikullin 231, kemi pakësim fondi në shumën 160,000 mijë lekë.

5. Programi “ Mbështetje për Shëndetësinë”

Në total për vitin 2024 kemi rritje të buxhetit në shumën 37,726,289 lekë në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 75,320,000 lekë.

Në artikullin 602 kemi shtesë fondi në shumën 89,980,000 lekë.

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 2,426,289 lekë.
Në artikullin 231 kemi pakësime fondi në shumën 130,000,000 lekë.

6. Programi “Mbështetje për Ushtarakët”

Në total për vitin 2024 kemi rritje të buxhetit në shumën 43,000 lekë në krahasim me buxhetin fillestar në artikullin buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 604 kemi shtesë fondi në shumën 43,000 lekë.

7. Programi “Emergjencat Civile”

Në total për vitin 2024 kemi pakësim të buxhetit në shumën **1 955 344 000 lekë** në krahasim me buxhetin fillestar sipas artikujve buxhetorë të mëposhtëm:

Në artikullin 600 dhe 601 kemi shtesë fondi në shumën 28 059 000 lekë.

Në artikullin 602 kemi pakësim fondi në shumën 172 469 000 mijë lekë.

Në artikullin 604 kemi pakësim fondi në shumën 18 000 000 mijë lekë.

Në artikullin 605 kemi pakësim fondi në shumën 5 000 000 mijë lekë.

Në artikullin 606 kemi shtesë fondi në shumën 1 686 000 lekë.

Në artikullin 231 investime të brendshme (01) kemi pakësim fondi në shumën 196 890 000 lekë.

Në artikullin 231 investime të huaja (02) kemi pakësim fondi në shumën 1 592 550 000 lekë.

Në sistemin e thesarit SIFQ fondi për investime të huaja në vlerën **2 012 050 000 lekë** fond nuk çelet në sistemin e thesarit dhe përbën tavanin e investimeve të huaja, të cilat mund të përthith programin buxhetor “Emergjencat Civile” gjatë vitit buxhetor. Informacioni lidhur me realizimin e këtyre investimeve kapitull (02) realizohet nëpërmjet informacionit të gjeneruar nga sistemi AFMIS.

Numri i punonjësve:

Numri total i punonjësve i miratuar me ligjin e vitit 2024 është **8 863** veta, sipas strukturave kryesore për programet është i detajuar, si më poshtë:

1. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	409 punonjës ose	5 % e totalit
2. Forcat e Luftimit	3971 punonjës ose	45 % e totalit
3. Mbështetja e Luftimit	3406 punonjës ose	38 % e totalit
4. Arsimimi Ushtarak	397 punonjës ose	5 % e totalit
5. Mbështetja për Shëndetësinë	484 punonjës ose	5 % e totalit
6. Emergjencat Civile	196 punonjës ose	2 % e totalit

Për programin “Forcat e Luftimit” që zë dhe përqindjen më të madhe të numrit të punonjësve, numri faktik mesatarisht në muaj për këtë periudhë është 3,826 punonjës dhe diferenca prej 145 punonjës parashikohet të plotësohet në vijim.

Për informacion përmbledhës, lutemi referojuni aneksit nr. 1: Raporti i Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor.

II. PERFORMANCA E TREGUESVE KYÇ TË PERFORMANCËS ME BAZË GJINORE, NË NIVEL PRODUKTI

Të gjitha programet buxhetore të ministrisë, në respektim dhe promovim të plotë të barazisë gjinore, kanë përcaktuar tregues gjinorë konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm në nivel qëllimi dhe objektivi. Gjithashtu duke marrë në konsideratë edhe sugjerimet e Drejtorisë së Analizës dhe Programimit Buxhetor (Ministria e Financave), nga të gjithë programet buxhetore janë përfshirë edhe disa tregues kyç të performancës që lidhen me buxhetimin mbi bazë gjinore dhe vlerat e synuara për këto tregues janë pjesë e raporteve të monitorimit gjatë vitit 2024.

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” ka përcaktuar tregues gjinorë në nivel qëllimi, si më poshtë:

Qëllimi: Të kontribuojë në miradministrimin, menaxhimin efektiv të fondeve dhe përmbushjen e detyrimeve financiare për personelin e MM-së dhe SHPFA-së, Përfaqësitë Ushtarake, Shtabet e NATO-s, sipas detyrimeve ligjore të përfshirjes në iniciativat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare”.

- Rekomandime të zbatuara të auditimeve të kryera;
- Raporti gra/burra për program;
- Gra të përfaqësuara në nivele drejtuese.
- Numri i grave të përfaqësuara në nivele drejtuese kundrejt numrit të burrave në të njëjtin pozicion.

Objektivi: “Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare”.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në % dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

2. Programi “Forcat e Luftimit” ka përcaktuar tregues gjinorë në nivel qëllimi, si më poshtë:

Qëllimi: “Të kontribuojë në sigurimin e një force luftimi tokësore, detare dhe ajrore operationale të mirëstërvitur, profesionale e të ndërveprueshme me NATO.

Koordinimin e politikave për planifikimin dhe arritjen e rezultateve në përdorimin me efektivitet të fondeve, duke hartuar dhe zbatuar strategji për minimizimin e riskut.

Raporti gra/burra për program.

- Numri i grave në pozicionet drejtuese kundrejt numrit të burrave në të njëjtin pozicion.

Objektivi “Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare”:

Të gjithë këto tregues janë të matshëm në numër dhe në %, dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

3. Programi “Mbështetja e Luftimit”

Qëllimi i këtij programi është “Mbështetja me logjistikë, inteligjencë strategjike, shërbimet operationale të mbrojtjes civile, në luftën kundër korrupsionit në Forcat e Armatosura, për siguri dhe stabilitet:

- Niveli i mbështetjes me shërbime për FA-në;
- Niveli i mbështetjes operationale për FA-në;
- Gra në drejtim dhe gra të trajnuara në FA.

Objekti: “Sigurimi i sistemeve të armatimit, teknikës, pajisjeve të avancuara për të gjitha strukturat e parashikuara për angazhime në operacionet e NATO, BE, OKB etj.”

Treguesit e performancës për këtë objekt:

- Përqindja e furnizimit në kohë dhe mbështetja logjistike e FA-së;
- Menaxhimi në kohë dhe profesional i operacioneve të EC-së dhe CIMIC.

4. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Qëllimi i këtij programi është: “Arsimimi, trajnimi, stërvitja dhe përgatitja e personelit ushtarak dhe civil të FA-së, për të përmbushur detyrimin kushtetues të sigurimit të pavarësisë së vendit, pjesëmarrje aktive në misionet ushtarake të NATO-s, si dhe në përballimin e emergjencave civile”.

Tregues performance: Ushtarakë të aftë e të përgatitur për të përballuar me sukses misionet në kuadër të NATO-s, OKB-së, BE-së etj.

- Personel i aftë i angazhuar në përballimin e emergjencave civile;
- Ushtarakë profesionistë të aftë për mbrojtjen territoriale dhe pavarësisë së vendit etj.

Objekti: Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse në përputhje me standardet e NATO-s”.

Tregues të performancës:

- Numër personeli i trajnuar;
- Numër personeli i stërvitur;
- Numër ushtarakësh të ri të trajnuar dhe pranuar kundrejt numrit të aplikimeve;
- Numër personeli që përfundojnë trajnimet dhe kalojnë testet;
- Numër manualesh të botuara kundrejt planifikimit;
- Numër kërkimesh shkencore të publikuara kundrejt planifikimit;
- Numër studimesh të zhvilluara për standardizimin e FA-së;
- Numër personeli ushtarak të gjinisë femra të pranuar në FA.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në %, dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

Për informacion më të hollësishëm, lutemi referojuni aneksit nr. 4: Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit, ku janë përfshirë edhe treguesit me bazë gjinore.

5. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”

Qëllimi kryesor: “Shërbim shëndetësor të specializuar mjekësor dhe spitalor në nivel universitar në trajtimin në rang kombëtar të politraumave”.

Tregues i performancës:

- Numri i shtrimeve reaminatore;
- Numri total i operacioneve sipas specialiteteve;
- Numri i ekzaminimeve imazherike;
- Numri i ekzaminime laboratorike;
- Numri i vizitave ambulatorie në poliklinikë;

- Numri i ditëve të qëndrimit mesatar në spital;
- Numri i urgjencave të kirurgjisë dhe terapisë;
- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjente në SUT;
- Numri i operacioneve të planifikuara dhe urgjente për çdo sallë operacioni.

Të gjithë këto tregues janë të matshëm në numër dhe në % dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

6. Programi “Mbështetje për Ushtarakët”

Qëllimi kryesor: Sigurimin dhe mbështetjen financiare e ushtarakëve në rezervë dhe në lirim, trajtim të vecantë të ushtarakëve të nëndetëseve në pension dhe pilotëve fluturues në pension. Përcaktimi, vlerësimi dhe planifikimi i përfituesve sipas këtyre kategorive dhe tregues performance:

% e mbështetjes financiare të ushtarakëve në rezervë dhe në lirim.

Objekti: Trajtim të veçantë të ushtarakëve, ushtarakëve të nëndetëseve në pension dhe pilotëve fluturues në pension, tregues i performancës:

-Numër përfituesish ushtarakë.

Të gjithë këto tregues janë të matshëm në numër dhe në % dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

7. Programi “Emergjencat Civile” ka përcaktuar tregues gjinorë në nivel qëllimi, si më poshtë:

Qëllimi: “Mbrotja e jetës së shtetasve, pronës së tyre, gjësë së gjallë, mjedisit, objekteve social-kulturore dhe të rëndësishë të veçantë, objekteve të trashëgimisë kulturore, infrastrukturës kritike etj., nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësi që shkaktohen nga veprimtari njerëzore, duke koordinuar veprimet e strukturave operationale që kanë përgjegjësi në fushën e emergjencave civile”.

Objekti: Zvogëlimi e humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.

- Numër ndërhyrjesh të ofruara në rast tërmeti;
- Numër ndërhyrjesh të ofruara në rast përmytje;
- Numër ndërhyrjesh të ofruara në rast zjarri.

Objekti: “Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore”.

- Rritja e stokut të mallrave rezervë shteti, të cilat do të përdoren për t’i ardhur në ndihmë familjeve të prekura nga fatkeqësitë natyrore me mallra rezervë shtetërore.

Të gjithë këta tregues janë të matshëm në numër dhe në % dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 6% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 94 %.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet, si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 96 %,

Nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 98 %;
- Shpenzime të tjera, në masën 95%.
- Shpenzime Kapitale, në masën 69%,

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve,

Janë parashikuar **3 produkte** me vlerë **1,902,910** mijë lekë dhe janë realizuar **3 produkte** me vlerë **1,830,147** mijë lekë (duke përfshirë edhe kap.02) ose 96 %, të cilat paraqiten, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	% e realizimit
	Totali i Shpenzime Korrente	96
1.	Akte ligjore e nënligjore të përgatitura	94
2.	Marrëveshje të realizuara	100
3.	Sisteme të mirëmbajtura	100
4.	Totali Shpenzime për Investime	69
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me Financim të Brendshëm	69
1.	Përmirësimi në harduerë/softuerë dhe ndërtime të dhomave të serverave	8
2.	Krijimi i Qendrës së Inovacionit për cyber security	100
3.	Blerje pajisje Tik për MM dhe FA	100
4.	Blerje automjeti për Përfaqësitë Ushtarake	86
5.	Sistemi i automatizimit të Burimeve të Mbrojtjes (J-6)	100

Shpenzimet e programit për investime.

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm + financim i huaj),

Nga 8 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 5 projekte. Realizimi faktik është në vlerën **110,267** mijë lekë ose 69%.

Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

Trajtimi i çështjes së barazisë gjinore.

Nga programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” janë përcaktuar tregues konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm të cilët janë identifikuar, produktet me kostot përkatëse që kontribuojnë në realizimin e tyre.

2. Programi “Forcat e Luftimit”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 44% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 90.8 %.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 98.3 %,

Nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 99.6 %;
- Shpenzime të tjera, në masën 96.5 %.
- Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm, në masën 84.5%;
- Shpenzime Kapitale me financim të huaj, në shumën 0 %.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve:

Janë parashikuar 4 produkte me vlerë 7,389,405 mijë lekë dhe janë realizuar 4 produkte me vlerë 7,265,778 mijë lekë ose 98.3 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	% e realizimit
	Totali i Shpenzime Korrente	98.3
1.	Forca Tokësore në gatishmëri dhe operacione	99.2
2.	Kontingjente ushtarake në misione paqeruajtëse	100
3.	Forca Detare në gatishmëri dhe operacione	95.7
4.	Forca Ajrore në gatishmëri dhe operacione	97.7
	Totali Shpenzime për Investime	84.5
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	84.5
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0
1.	Ndërtim objektsh dhe punime për rikonstruksione të godinave të KFT Zall-Herr	58
2.	Armatim i lehtë, municione dhe aksesore, makineri e pajisje	85
3.	Ndërtim i rrjetit inxhinierik i poligonit Kombëtar Pajet/Ndërtim infrastrukturor i rajonit stërvitor Pajet	53
4.	Ngritja e sistemit të sigurisë dhe i rrethimit të Poligonit Kombëtar Pajet	99
5.	Tvsh për objektet ndërtimore	44
6.	Ndërtim i sistemit autonom panele diellore (PRT dhe Vendbazimi Sazan, prona nr. 915).	100
7.	Rikonstruksion për instalimin e sistemeve të ndërlidhjes dhe informacionit në Flotiljen detare Pashaliman	0
8.	Ndërtim i sistemit të rrjetit elektrik maja e Thanasit Llogara (prona nr. 915).	99
9.	Predha për topin automatik 20 mm, 9102 HEI, të anijeve të klasit "Iliria"	100
10.	Rinovimi dhe përmirësimi teknologjik i sistemit SIVHD, pajisja me kamera vëzhgimi infra të kuqe dhe ruajtje të integruara me sistemin SIVHD, mirëmbajtje afatmesme SIVHD	100
11.	Ndërtim i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (prona nr.240, godina nr.34) dhe rikonstruksion i pjesshëm i godinës, rikonstruksion i objektit 2 katësh	0
12.	Punime infrastrukturore Baza Ajrore Kuçovë	30
13.	Shpronësime tokash Kuçovë	27
14.	Hangarët për helikopterët Blackhawk	100
15.	Hangarë mjedise për mirëmbajtjen e riparimit dhe të testimit.	79
16.	Ndërtim i perimetrit të sigurisë në Bazën Ajrore Kuçovë.	78
17.	Rikonstruksion i Shtëpisë së Usharakëve Kuçovë.	0
18.	Kapaciteti i avionëve pa pilot të armatosur /Dron UAV së bashku me sistemet e komandim-kontrollit	100
19.	Kompletimi me kapacitet të zbulimit dhe neutralizimit të objekteve pa pilot	100
20.	Krijimi i kapitalit fillestar "KAYO"	100
21.	Sisteme komunikimi dhe informacioni Baza Ajrore e NATO-s, Kuçovë	100
22.	Rrjeti inxhinierik dhe TAXIËAY Farkë	0
23.	Fond i ngrirë	0
24.	Kapacitete të ofruara në modernizim	0

Shpenzimet e programit për investime.

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm dhe financim i huaj).

Nga 24 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 18 projekte. Realizimi faktik është në vlerën 7,433,459 mijë lekë ose 84.5%.

Ky nivel realizimi është nga mos çelja e Shpenzimeve Kapitale me financim të huaj në SIFQ. Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

Trajtimi i çështjes së barazisë gjinore.

Nga programi “Forcat e Luftimit” janë përcaktuar tregues konkretë të përshtatshëm dhe të matshëm të cilët janë identifikuar gjatë vitit 2024.

3. Programi “Mbështetja e Luftimit”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 27% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 91%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 96 %,

Nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 98 %,
- Shpenzime të tjera, në masën 92 %.
- Shpenzime Kapitale në masën 60%,

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve.

Janë parashikuar 13 produkte me vlerë 7,409,478 mijë lekë dhe janë realizuar 13 produkte me vlerë 6,763,925 mijë lekë ose 91 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	% e Realizimit
	Totali i Shpenzimeve korrente	96
1.	Kapacitete Operacionale që sigurojnë mbështetjen logjistike të FARSH	97
2.	Qendra e Kulturës funksionale	93
3.	Arkive funksionale	93
4.	Personel i rekrutuar dhe dosje të administruara për trajtim financiar	89
5.	Sistem i Automatizuar Logjistik i Menaxhuar	99
6.	Licenca import/eksportit të dhëna	93
7.	Harta ushtarake të prodhuara	96
8.	Inteligenca ushtarake për autoritetet e drejtimit dhe komandimit të FA-së	96
9.	Hapësirë detare e monitoruar	87
10.	Polici ushtarake funksionale	61
11.	Sistem funksional kontrolli për FA	95
12.	Objekte në ruajtje dhe godina pushimi të ofruara	98
13.	Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë	96
	Totali i shpenzimeve për investime	60

	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	60
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	
1.	Mjete transporti dhe speciale FA	0
2.	Pajisje dhe softë për përmirësimin e sistemit në AISM	98
3.	Zhvillimi i kapaciteteve O1001, K1002, S1003, S1004, L1005, N1006, N1007, R1008, I1009, M1010, M1011	56
4.	"Ngritja e sistemit të informacionit për gjeografinë dhe infrastrukturës ushtarake në shërbim të IGJIU"	100
5.	Sistemi i dixhitalizimit të dokumenteve arkivore	0
6.	Kompletim i ambienteve për Zyrat e Rekrutimit në rrethe	94
7.	Abonimi dhe suporti teknik vjetor për setin e programeTeledzne Cartis, për realizim e hartave detare elektronike ENC dhe harta detare në letër në vazhdim të projektit ALNO-HIP	0
8.	Abonimi dhe suporti teknik vjetor për programin SevenCs, për realizimin e kontrollit të saktësisë së hartave detare elektronike ENC në vazhdim të projektit ALNO-HIP	0
9.	Programe të licencuara për sektorët e IGJIU-së (AutoCadcivil, Autocadmap3D, Sletch up etj.)	0
10.	Zhvillimi i kapaciteteve Ç1009; M1019; P1020; S1021; P1022; P1023; T1012; Z1024; Z1025; R1014; R1015; I1016	0
11.	Përmirësimi i sistemeve të MM/FA për sigurinë kibernetike	0
12.	Rikonstruksion Godine	0
13.	Rikonstruksion ambientesh, blerje aparaturash mjekësore e dentare dhe pajisje orendi	100
14.	Përshtatje dhe rikonstruksion ambientesh për Zyrat e Rekrutimit në rrethe	0
15.	Ndërtim objekti shumëfunksional për akomodimin e Komandës, Shtabit dhe Kompanisë së Mbështetjes në pronën nr.86 C Ferraj, Tiranë	94
16.	Rikonstruksion tërësor i ndërtesës së Komandës dhe shtabit të Batalionit (Rep 4007) dëmtuar nga tërmeti, rrethimi, sistemi i sigurisë, ndërtim depo karburanti, rikonstruksion oficine, rikonstruksion parqesh prona nr.149 Pezë-Helmës	87
17.	Rikonstruksion ndërtesash, rrethim pjesor, ndërtim sistem sigurie Rep. nr.4009 prona nr.176 Ferraj, Tiranë	100
18.	Ndërtim grup-depo për administrimin e pajisjeve dhe akomodimin e kompanisë II të kërkim-shpëtimit, në pronën nr.86, Reparti Ushtarak nr. 4030, Ferraj, Tiranë	51
19.	Rikonstruksion deposh, godina 1 katëshe, truproje, rrethim pjesor, sistem sigurie grup depo Mengel prona nr.318, 319 Mengel	82
20.	Rikonstruksion truproje, rrethim pjesor sistem sigurie pjesor prona nr.122 Marikaj Vorë	100
21.	Rikonstruksion truproje, rrethim pjesor sistem sigurie pjesor prona nr.122 Marikaj Vorë	100
22.	Përshtatja e ambienteve të reja në Garnizonin Skënderbej për magazinimin e produkteve hartografike sistemit i arkivit dhe magazinës së materialeve të gazermimit	81
23.	Godinë 3K (Mbulim me çati, rikonstruksion i ambienteve të brendshme, nyjave higjieno-sanitare, rikonstruksion rrjeti elektrik, ventili & kondicionim)	0
24.	Godinë 2K (Mbulim me çati, rikonstruksion i nyjave higjieno-sanitare)	0
25.	Rrethim i repartit 6604	0
26.	Rikonstruksion godine 3-K, zyra e PU, Berat	0
27.	Rikonstruksion i objektit Qendra e Personel-Rekrutim Godina nr.35.	0
28.	Blerje pajisje hardëare për rrjetet e paklasifikuara në FA	99
29.	Ndërtimin e sistemit të Telefonise VoIP & VTC në FA(Radiorele Digitale) + FD	0
30.	Licenca dhe programe softëurike për FA	41
31.	Pajisje harduerike për rrjetin e klasifikuar të FA	0
32.	Ndërtim/zgjerim i rrjetit të fibrës optike në FA	0
33.	Ndërtimi i sistemit të trasmetimit shumëkanalësh me vale FD	0
34.	Rrjeti Kombëtar i Klasifikuar NATO Sekret	0
35.	Blerje e pajisjeve simulatore	95
36.	Blerje pajisje elektronike (TIK)	76
37.	Blerje pajisje elektronike (TIK) për Muzeun Bërzhitë	0
38.	Blerje pajisje vegla muzikore për OSFA - në	0
39.	Automatizimi i Burimeve të Mbrojtjes (Përmirësimi i sistemit të automatizimit, SIMB)	0
40.	Përmirësim në hardëare, softëare dhe ndërtime të dhomave të serverave, për rritjen e performancës së sistemeve të MM/FA për vazhdueshmërinë e punës (business continuity) sipas standardeve të NATO-s.	0
41.	Ndërtimi i Muzeut të madh të Forcave të Armatosura	100
42.	Rikonstruksion i godinave të dëmtuara nga tërmeti prona 231 në SHPU Durrës Vila nr.1 dhe nr.2 (seksioni i vjetër) nr.4 dhe nr.8	0
43.	Rrethim i pronës nr.108 (Venddislokimi i batalionit)	0
44.	Pajisje hotelerie për SHPU Jale, Durrës, Pogradec dhe Vlorë	0
45.	Sistemi i infrastrukturës + Postobloku nr.4 + Tranazhim i fushës së futbollit në Garnizonin "Skënderbej"	100
46.	Rikonstruksion i dy objekteve tip tunel në pronën nr.206 Bërzhitë Tiranë	0
47.	Përmirësim dhe riparim i sistemit të cillerave në garnizonin "Skënderbej"	0
48.	Pajisje zyresh të Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike	0
49.	Pajisje me elementet e sistemit të sigurisë elektronike në Rep.Usht.Nr.6630 Garnizoni "Skënderbej", OFFA dhe SHPU	0

50.	Studime e projekte (Art.230)	0
51.	Blerje Droni	0
52.	TVSH	0
53.	Rikonstrukcion zyre	0

Shpenzimet e programit për investime,

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm dhe financim i huaj),

Nga 53 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 19 projekte. Realizimi faktik është në vlerën 638,800 mijë lekë ose 60%.

Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

Ndryshimet në volumin e buxhetit :

Sipas shkresës së sekretarit të përgjithshëm në MM nr.1850 prot., datë 28.03.2024, “Dërgim miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2024, për programin “Mbështetja e Luftimit” kemi shtesë në artikullin 606 “Fondi i veçantë” në vlerën 16,505 mijë lekë.

2. Sipas shkresës së sekretarit të përgjithshëm në MM nr. 4580/1 prot., datë 14.08.2024, “Akordim fondi për rritjen e pagave për vitin 2024” për programin “Mbështetja e Luftimit” kemi:

- Shtesë në artikullin 600 në vlerën 29,918 mijë lekë.
- Shtesë në artikullin 601 në vlerën 73,075 mijë lekë.
- Pakësim në artikullin 602 në vlerën 832,049 mijë lekë.
- Shtesë në artikullin 606 në vlerën 28,598 mijë lekë.
- Shtesë në artikullin 604 në vlerën 290,000 mijë lekë për likuidimin e detyrimeve të prapambetura të uzinave ushtarake (Poliçan, Mjekës dhe Gramsh).
- Për vitin 2024, për programin “Mbështetja e Luftimit” janë likuiduar detyrime të prapambetura të llogaritura ndër vite gjithsej 110,434,311 lekë.

4. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 3.4% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 93%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 99 %,

Nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 100 %,
- Shpenzime të tjera, në masën 98 %,
- Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm, në masën 81%.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve:

Janë parashikuar 1 produkt dhe 8 projekte me vlerë 1,265,332 mijë lekë dhe janë realizuar 1 produkt dhe 7 projekte me vlerë 1,171,873 mijë lekë ose 93 %, të cilat paraqiten, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	% e realizimit
		93%
	Totali i Shpenzime Korrente	96
1.	Kapacitete të afta për trajnimin dhe arsimimin cilësor në Forcat e Armatosura	93%
	Totali Shpenzime për Investime	69
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	69
1.	Ndërtim sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike në QAPU	99%
2.	Hidroizolimi i magazinave të materialeve dhe depove të AM, godina 4 katëshe blloku të mensës dhe ish - Komandës	83%
3.	Ndërtimi i godinës së re të AFA (Prona.21)	99%
4.	Blerje 35 licenca VBS3 dhe 15 Laptopë për VBS3 (MTT)	100%
5.	Arredim i ambienteve të brendshme të godinave, fakultet dhe muncë kuzhinë e Kampusit të ri të AFA, e re me AN	0%
6.	Kompletimi me pajisje informatike dhe teknologjike të dy godinave të masterplanit (fakultetit dhe mensës) TIK	76%
7.	Pasurimi me literaturë të bibliotekës së AFA	94%
8.	Blerje pajisje (kondicionerë, lavatriçe, makinë tharëse rrobash, televizorë, frigoriferë, bolierë, tavolinë dhe hekur hekurosje)	100%

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2024, pa përfshirë kapitullin 06, paraqitet në shumën **1,171,873 mijë lekë ose 93 %**.

Shpenzimet e programit për investime

Nga 8 projekte të parashikuara për investime (financim i brendshëm, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 7 projekte, realizimi faktik i të cilave është në vlerën 356,149 mijë lekë ose 81%. Ky nivel realizimi është si rezultat i mosrealizimit të procedurave të prokurimit.

5. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 5.2% të buxhetit me ndryshime të miratuar për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 98%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet, si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 99.5 %,

Nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 99.7%,
- Shpenzime të tjera, në masën 99.2%,
- Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm, në masën 91.7%.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve:

Janë parashikuar **1 produkte dhe dy projekte** me vlerë **1,943,726 mijë lekë**, është rishikuar gjatë vitit buxheti në vlerë 1,943,726 mijë lekë dhe janë realizuar në total **1 produkt dhe dy projekte** me vlerë **1,905,423 mijë lekë** (duke përfshirë edhe kap.602) ose 98 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	% e realizimit
	Totali i Shpenzime Korrente	98
1.	Pacientë të trajtuar ambulator dhe të shtruar të urgjencës	100
	Totali Shpenzime për Investime	92
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	92
1.	Rikonstruksion Godinash	100
2.	Blerje Aparatura dhe Pajisje Mjekësore	92

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2024, pa përfshirë kapitullin 06, paraqitet në shumën **1,905,423** mijë lekë ose 98 %.

Shpenzimet e programit për investime.

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm).

Nga 8 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 7 projekte, realizimi faktik i të cilave është në vlerën 339,449 mijë lekë ose 81%.

6. Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 14.1% të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese. Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 100%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 100 %,

Nga të cilat:

- Shpenzime për Transferta Korrente të Brendshme, në masën 100 %.

Janë parashikuar 5 produkte me vlerë 5,243,000 mijë lekë dhe janë realizuar 5 produkte me vlerë 5,243,000 mijë lekë ose 100 %, të cilat paraqiten, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	% e realizimit
	Totali i Shpenzime Korrente	100
1.	Sigurimin suplementar të ish-ushtarakëve dhe ish-policëve	100%
2.	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të pilotëve fluturues në pension	100%
3.	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të punonjësve të industrisë ushtarake	100%
4.	Përfitime të llogaritura dhe shpërndara për trajtimin e veçantë të ushtarakëve të nëndetëseve në pension	100%
5.	Kontributet e buxhetit të shtetit në bazë të legjislacionit për financimin e ushtarakëve në pension të parakohshëm	100%

Realizimi i Shpenzimeve korrente për programin për vitin 2024, paraqitet në shumën **5,243,000** mijë lekë ose 100 %.

7. Programi “Emergjencat Civile”

Fondet e akorduara për këtë program buxhetor përbëjnë rreth 8 % të buxhetit me ndryshime të miratuara për MM-në për periudhën raportuese.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore ndaj planit vjetor të rishikuar është në masën 70.3%.

Sipas klasifikimit ekonomik, realizimi paraqitet, si më poshtë:

Shpenzime korrente, realizimi është në masën 84.1%,

Nga të cilat:

- Shpenzime personeli, në masën 98%;
- Shpenzime të tjera, në masën 81.2%,
- Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm, në masën 74%;

Sipas burimit të financimit, realizimi paraqitet si më poshtë:

- Financimi i Brendshëm, realizimi është në shumën 2 354 666 mijë lekë ose **78.3%**.
- Financimi i Huaj, realizimi është në shumën 50 383 mijë lekë ose **12%**.

Performanca e shpenzimeve sipas produkteve:

Janë parashikuar 19 produkte me vlerë 3,426,706 mijë lekë dhe janë realizuar 15 produkte me vlerë. 2,409,249 mijë lekë (duke përfshirë edhe kap.02 dhe të ardhurat jashtë limitit kapitull 06) ose 70.3 %, të cilat paraqiten si më poshtë:

Nr.	PRODUKTET	% e realizimit
1.	Mbrojtja e jetës njerëzore, pronës, trashëgimisë kulturore dhe pyjeve ndaj zjarrit	98.00%
2.	Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme.	83%
3.	Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme, për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve.	69%
4.	Stoku i mallrave ushqimore (rezervë materiale shtetërore)	64%
5.	Stoku i mallrave industriale (rezervë materiale shtetërore)	98%
6.	Masa parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese në disa bashki të vendit	74%
7.	Blerje software për përmirësimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm	0
8.	Aplikimi i sistemeve të informacionit gjeografik (GIS) dhe Web GIS	0
9.	Blerje softëare baza e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë	100%
10.	Ndërtim i stacioneve Hidro-meteorologjike	0%
11.	Blerje mallra rezervë shteti ushqimore	0%
12.	Blerje mallra rezervë shteti industrial	100%
13.	Blerje ushqim për bagëti	99%
14.	Bashkëfinancim me projektet e huaja	0
15.	Bashkëfinancim me projektet e huaja Roses	88%
16.	Bashkëfinancim me projektet e huaja Flood North Albania	36%
17.	Bashkëfinancim me projektet e huaja Local Drm	72%
18.	Bashkëfinancim me projektet e huaja Sa Resilience	79%
	TOTALI	70.30%

Realizimi i Shpenzimeve korrente dhe kapitale për vitin 2024, pa përfshirë kapitullin 06, paraqitet në shumën 2,405,049 mijë lekë.

Shpenzimet e programit për investime

Shpenzimet e programit për investime (financim i brendshëm dhe financim i huaj),

Nga 12 projekte të parashikuara për investime, duke përfshirë edhe rialokimet gjatë vitit janë realizuar 10 projekte, realizimi faktik i të cilave është në vlerën **1 325 552 mijë** lekë ose 62%.

Ky nivel realizimi është nga mos çelja e Shpenzimeve Kapitale me Financim të Huaj në SIFQ. Analitikisht tabela e projekteve të investimeve të programit i bashkëlidhet këtij relacioni.

III. PERFORMANCA JOFINANCIARE E PROGRAMEVE BUXHETORE

1. Programi “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”

Qëllimi i këtij programi është: Të kontribuojë në miradministrimin, menaxhimin efektiv të fondeve dhe përmbushjen e detyrimeve financiare për personelin e MM-së dhe SHPFA-së, Përfaqësitë Ushtarake, Shtabet e NATO-s, sipas detyrimeve ligjore të përfshirjes në iniciativat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare, duke bërë të mundur koordinimin e politikave për planifikimin dhe arritjen e rezultateve në përdorimin me efektivitet të fondeve, duke hartuar dhe zbatuar strategji sektoriale, në përputhje me standardet e NATO-s.

Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike dhe plane veprimi për realizimin e tyre. Për vitin 2024 objektivat kryesore janë:

- Menaxhimi me eficiencë dhe efektivitet i burimeve njerëzore dhe financiare.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Politika dhe/ose strategji sektoriale të miratuara, në përputhje me standardet e NATO-s;
- Përqindja e punonjësve të trajnuar kundrejt totalit;
- Nr. raporte vlerësimi të kryera;
- Nr. akte ligjore e nënligjore të përgatitura kundrejt planifikimit;
- Nr. auditime të kryera kundrejt planifikimit;
- Nr. procese rekrutimi të kryera;
- Nr. marrëveshesh të realizuara kundrejt planifikimit.

Performanca e treguesve sa më sipër matet me bazë vjetore.

2. Programi “Forcat e Luftimit”

Qëllimi i këtij programi është: Për një forcë luftimi operacionale, të mirëstërvitur, profesionale edhe në përputhshmëri me standardet e NATO-s.

Programi “Forcat e Luftimit” përmban 3 nënprograme: **Komanda e Forcës Tokësore, Komanda e Forcës Detare dhe Komanda e Forcës Ajrore**. Për secilin nga këto nënprograme janë parashikuar objektiva specifike.

Objektivat kryesorë janë:

Objektivi 1: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Tokësore.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Niveli i kompletimit me personel;
- Niveli i trajnimit;
- Përqindja e grave në forcat tokësore.

Objektivi 2: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Detare.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Kapacitete operacionale për Flotiljen Detare;
- Kapacitete operacionale për Qendrën e Vëzhgimit;
- Kapacitete operacionale për Shërbimin Hidrografik Shqiptar;
- Përqindja e grave në forcat detare.

Objektivi 3: Mbajtja në gatishmëri dhe përmirësimi i kapaciteteve operacionale të Forcës Ajrore.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Plotësimi me personel, pajisje, trajnime, stërvitje e resurse të BAJ Farkë/nivel 2;
- Plotësimi me personel, pajisje, trajnime, stërvitje e resurse të QKR.

Performanca e treguesve sa më sipër matet me bazë vjetore.

3. Programi “Mbështetja e Luftimit”

Qëllimi i këtij programi është: “Të sigurojë logjistikën e nevojshme, si dhe mbështetjen në operacione humanitare e misione ndërkombëtare, sigurimin e inteligjencës strategjike të nevojshme dhe sipas standardeve të NATO-s për siguri dhe stabilitet, sigurimin dhe mbështetjen e sistemeve të teknologjisë brenda standardeve të NATO-s, rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak dhe civil”.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Niveli i mbështetjes me shërbime për FA-në;
- Përqindja e furnizimit në kohë dhe mbështetja logjistike e FA-së;
- Menaxhimi në kohë dhe profesional i operacioneve të EC-së dhe CIMIC;
- Niveli i mbështetjes operacionale për FA-në;
- Përqindja e grave të trajnuara në FA;
- Gra në nivele drejtuese në strukturat e FARSH-it;
- Mbështetja me logjistikë, inteligjencë strategjike, shërbimet operacionale të mbrojtjes civile, në luftën kundër korrupsionit në Forcat e Armatosura, për siguri dhe stabilitet;
- Pajisja me licencë importi/eksporti për mallrat ushtarak dhe mallra me përdorim të dyfishtë si dhe lëndë plasëse.
- Sigurimi me sisteme komunikimi dhe informacioni (radiokomunikim, telekomunikacion, rrjete kompjuterike, VTC, BUE, PDSHD), në mbështetje të kërkesave të komandim-kontrollit të Forcave të Armatosura në nivelin strategjik, operacional dhe taktik në kohë paqe, krize dhe lufte. Menaxhimi i Sistemit të Integruar të Automatizimit të Burimeve të Mbrojtjes në FA.

Të gjithë këto tregues janë të matshëm në numër dhe në % dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

4. Programi “Arsimimi Ushtarak”

Qëllimi i këtij programi është: Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil, nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet e NATO-s.

Objektivi kryesor i këtij programi është:

Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe transformimi i sistemit të edukimit ushtarak e civil nëpërmjet programeve të integruara dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me standardet e NATO-s.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Numër personeli i trajnuar;
- Numër personeli i stërvitur;
- Numër ushtarakësh të rinj të trajnuar dhe pranuar kundrejt numrit të aplikimeve;
- Numër personeli që përfundojnë trajnimet dhe kalojnë testet;
- Numër manualesh të botuara kundrejt planifikimit;
- Numër kërkimesh shkencore të publikuara kundrejt planifikimit;
- Numër studimesh të zhvilluara për standardizimin e FA-së;
- Numër personeli ushtarak të gjinisë femra të pranuar në FA;
- Gra në nivele drejtuese në strukturat e AFA-së

Të gjithë këto tregues janë të matshëm në numër dhe në % dhe monitorohen mbi bazë vjetore.

5. Programi “Mbështetje për Shëndetësinë”

Qëllimi i këtij programi është: “Shërbim shëndetësor të specializuar mjekësor dhe spitalor në nivel universitar në trajtimin në rang kombëtar të politraumave.

Objektit kryesor i këtij programi është:

1. Pritja dhe trajtimi i pacientëve të politraumatizuar në kohë reale pranë Urgjencës të SUT.

Treguesi i performancës për këtë objektiv:

- Numri i pacientëve të rishtuar për të njëjtën diagnozë;
- Koeficienti i shfrytëzimit të shtretërve;
- Koha e pritjes për ekzaminime të rëndësishme;
- Numri i vizitave ambulatorë;
- Numri i shtrimeve nga urgjenca.

2. Trajtimi shëndetësor dhe spitalor i pacientëve të afruara nga specialitetet mjekësore pranë SUT

Treguesi i performancës për këtë objektiv:

- Numri i shtrimeve reanimatore;
- Numri total i operacioneve sipas specialiteteve;
- Numri i ekzaminimeve imazherike;
- Numri ekzaminime laboratorike;
- Numri i vizitave ambulatorë në poliklinikë;
- Ditë qëndrimi mesatar në spital;

- Numri i urgjencave të kirurgjisë dhe terapisë;
- Numri i pacientëve të shtruar të planifikuar dhe urgjente në SUT;
- Numri i operacioneve të planifikuara dhe urgjente për çdo sallë operacioni

Performanca e treguesve sa më sipër matet me bazë vjetore.

6. Programi “Mbështetje Sociale për Ushtarakët”

Qëllimi i këtij programi është: Sigurimi dhe mbështetja financiare e ushtarakëve në rezervë dhe në lirim, trajtim të veçantë të ushtarakëve të nëndetëseve në pension dhe pilotëve fluturues në pension. Përcaktimi, vlerësimi dhe planifikimi i përfitueseve sipas këtyre kategorive.

Objektivi kryesor i këtij programi është:

Trajtim të veçantë të ushtarakëve, ushtarakëve të nëndetëseve në pension dhe pilotëve fluturues në pension.

Tregues i performancës:

-Numër përfituesish ushtarakë në rezervë dhe në lirim,
1,712 përfitues gra.

Performanca e treguesve sa më sipër matet me bazë vjetore.

7. Programi “Emergjencat Civile”

IV. PERFORMANCA JOFINANCIARE E PROGRAMIT BUXHETOR

Qëllimi i këtij programi është: Mbrojtja e jetës së shtetasve, pronës së tyre, gjësë së gjallë, mjedisit, objekteve social-kulturore dhe të rëndësisë së veçantë, objekteve të trashëgimisë kulturore, infrastrukturës kritike etj., nga fatkeqësitë natyrore apo fatkeqësi që shkaktohen nga veprimtari njerëzore, duke koordinuar veprimet e strukturave operacionale që kanë përgjegjësi në fushën e emergjencave civile.

Objektivat kryesorë të këtij programi janë:

Objekti 1. Zvogëlimi e humbjeve në jetë njerëzish, pasurisë, trashëgimisë kulturore dhe në mjedis.

Tregues të performancës:

- Evakuime të kryera;
- Strehime të bëra;
- Ushqime të ofruara;
- Uji i pijshëm i pastruar;
- Higjienë personale e ofruar;
- Ndërhyrje në rast tërmeti të ofruara;
- Ndërhyrje në raste përmytjesh të ofruara;
- Ndërhyrje në raste zjarri të ofruara;
- Ndërhyrje në aksidente në det;

- Dezinfektive të kryera;
- Hospitalizime të bëra;
- Transporte të ofruara;
- Kilometra rrugë të pastruara etj.

Objektivi 2. “Rritja e stokut në mallra ushqimore e industriale dhe krijimi i kushteve optimale për miradministrimin e mallrave të konsideruara si rezervë shtetërore”.

Tregues të performancës:

- Ton mallra ushqimore;
- Ton mallra industriale;
- Numër personash/familjesh që mund t’u vihet në ndihmë;
- Kohë gjatë të cilës mund t’u vihet në ndihmë rreth 4000 familjeve;
- Të ardhura të realizuara nga shitja e stokut të tepërt;
- Numër ankandesh të suksesshme të zhvilluara etj.

Për këtë program janë parashikuar objektiva specifike:

- Rritja e investimeve infrastrukturore me qëllim marrjen e masave parandaluese;
- Përmirësimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm;
- Rritja e kapaciteteve për ardhjen në ndihmë në rastet e fatkeqësive natyrore.

Treguesit e performancës për këtë objektiv:

- Numri i investimeve të financuara;
- Numri i qytetarëve të ndihmuar në raste zjarri, përmytje dhe tërmeti;
- Nr. i sistemeve paralajmëruese të vendosura në funksion.

Performanca e treguesve më sipër matet me bazë vjetore.

Theksojmë se për çdo program buxhetor nga analiza e kostos së produkteve të planifikuara me koston e produkteve në fakt ka ndryshime në produktet që përfshijnë artikujt 600 dhe 601 “Shpenzime personeli”, për shkak të ndryshimit të planit në krahasim me planin fillestar për shkak të rritjes së pagave me VKM-të përkatëse.

Për informacion më të detajuar mbi sasitë e produkteve të realizuara, koston faktike dhe deviacioneve të koston për njësi për çdo program buxhetor, lutemi referojuni aneksit nr. 3 “Raporti i performancës së produkteve të programit”, aneksit nr. 3.1 “Raporti i performancës së produkteve të programit sipas artikujve”, aneksit nr. 3.2: “Deviacioni koston për njësi në vite” dhe aneksit nr. 4 “Raporti i realizimit të treguesve të performancës së programit”, të cilat i gjeni bashkëlidhur me materialin.

PROJEKTET KAPITALE

Buxheti në total për vitin 2024 për projektet e investimeve është në vlerën **12,549,800 mijë lekë**, ndërsa realizimi është në vlerën **1,659,522 mijë lekë** ose në masën **81 %** (pa përfshirë kapitullin 6).

Sipas programeve buxhetore realizimi në mijë lekë paraqitet:

Nr.	Emërtimi i programit	Shpenzime kapitale (Fakti i vitit 2024)			Shpenzime kapitale të brendshme Viti 2024 në %
		Total Projekte të planifikuara	Projekte të realizuara	Vlera	
1.	Planifikim, Menaxhim dhe Administrim	7	5	110,267	69
2.	Forcat e Luftimit	21	18	7,433,459	85
3.	Mbështetja e Luftimit	40	21	638,800	60
4.	Mbështetja për Shëndetësinë	2	2	339,449	92
5.	Arsimimi Ushtarak	8	7	356,149	81
6.	Emergjencat Civile	11	8	1,275,168	74
	Totali i shpenzimeve të Ministrisë	89	61	10,153,292	81

- Planifikim, menaxhim dhe administrim, realizimi është në masën 69% kundrejt planit vjetor të investimeve
- Forcat e Luftimit, realizimi është në masën 85% kundrejt planit vjetor të investimeve;
- Mbështetja e Luftimit, realizimi është në masën 60% kundrejt planit vjetor të investimeve;
- Mbështetja për Shëndetësinë, realizimi është në masën 92% kundrejt planit vjetor të investimeve;
- Arsimimi Ushtarak, realizimi është në masën 81% kundrejt planit vjetor të investimeve;
- Emergjencat Civile, realizimi është në masën 74% kundrejt planit vjetor të investimeve.

Sipas burimeve të financimit realizimi paraqitet:

- **Projektet me financim të brendshëm** janë në vlerën **12,549,800** mijë lekë, realizimi është në vlerën **10,153,292** mijë lekë ose në masën **81%** kundrejt planit vjetor të investimeve.
- **Projektet me financim të huaj** janë në vlerën **5,247,453** mijë lekë, realizimi është në vlerën 0 mijë lekë ose në masën **0%** kundrejt planit vjetor të investimeve, pasi këto fonde nuk janë detajuar në SIFQ.

Projektet me financim të brendshëm për vitin 2024 janë realizuar në masën 81%, dhe ky realizim ka ndikuar në rritjen e gatishmërisë operationale të strukturave të Forcës Tokësore dhe numrin e personelit të mirëtrajtuar në kushte pune dhe stërvitje. Tregues që ndikojnë drejtpërsëdrejti në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese në Republikën e Shqipërisë dhe përmbushjen e objektivave si vend anëtar i NATO-s, pasi u arritën rezultatet e synuara, si më poshtë:

- U përmirësuan kushtet e punës për punonjësit në Forcën Tokësore dhe repartet e vartësisë, duke krijuar hapësira të reja dhe të rikonstruara sipas parametrave bashkëkohorë;
- U krijuan hapësirat e nevojshme të brendshme dhe të jashtme për stërvitjen dhe trajnimin e efektivëve (palestra, brez kalitje dhe poligone për qitje me armët e këmbësorisë);
- U krijuan hapësirat e nevojshme për ruajtjen dhe magazinimin e armatim-municionit, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në rregullore të posaçme;
- U rrit përqindja e kompletimit me armatim e pajisje luftarake, kapaciteteve operationale/resurseve të nevojshme për përballimin e situatave në vend dhe rajon;
- U përmirësua Sistemi i Vëzhgimit të Hapësirës Detare;
- U përmirësua sistemi i sigurisë në reparte, u përmirësua niveli i mbështetjes operationale për FA-në;
- U blenë pajisje teknologjike dhe informatike për Akademinë e Forcave të Armatosura;
- U ndërtua sistemi i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike në QAPU Forcave të Armatosura;
- U bë kompletimi me pajisje informatike dhe teknologjike i dy godinave të masterplanit (fakultetit dhe mensës);

- Janë rikonstruktuar ambiente dhe janë blerë aparatura mjekësore e dentare dhe pajisje orendi, duke krijuar të gjitha kushtet për marrjen e shërbimit sa më të shpejtë e cilësor për personelin ushtarak të FARSH-it;
- U ndërtua Muzeu i madh i Forcave të Armatosura sipas standardeve të reja, duke u krijuar ambiente të reja funksionale;
- U realizuan investimet në disa bashki të vendit, duke synuar zvogëlimin e mundësive për ndodhjen e fatkeqësive në këto zona;
- U përmirësua infrastruktura në software për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, duke ndikuar në krijimin e një database më të saktë të fatkeqësive natyrore për zonat e prekura nga fatkeqësitë dhe popullatës së ndikuar nga to;
- U rritën kapacitetet për përballimin e situatave emergjente me mallra industriale;
- U likuiduan detyrimet e përcaktuara në kontratat e projekteve me financim të huaj;
- U krijuan ambiente të reja për administrimin e pajisjeve të kërkim-shpëtimit;
- Janë blerë pajisje dhe softe për përmirësimin e sistemit në AISM;
- U ngrit sistemi i informacionit për gjeografinë dhe infrastrukturën ushtarake në shërbim të IGJIU-së;
- U përmirësuan kushtet e punës punonjësit, duke krijuar ambiente të reja sipas parametrave bashkëkohorë;
- U përmirësua infrastruktura hardware dhe software për rrjetet e paklasifikuara në FA.
- Blerje softesh për sistemin e paralajmërimit të hershëm;
- U rrit stoku rezervë shteti industrial, duke iu përafruar nomenkaturës së kërkuar nga legjislacioni në fuqi;
- U siguruan pajisje teknologjike dhe informatike për realizimin e procesi mësimor sa më efikas.

Gjatë vitit 2024, në disa projekte ka pasur mospërputhje mes ecurisë fizike me planin e financimit, duke ndikuar në mosrealizimin e buxhetit në masën 100%.

- Projekti “Ndërtim objektsh dhe punime për rikonstruksione të godinave të KFT Zall-Herr”, buxheti u realizua në masën 58%. Në realizimin e buxhetit të planifikuar ndikuan negativisht vonesat në përfundimin e procedurave të prokurimit, për caktimin e mbikëqyrësit të punimeve, vonesat në dorëzimin e sheshit të punimeve (vonesa në miratimin e objekteve që do të prisheshin për t’i hapur rrugë ndërtimeve të reja).
- Projekti “Ndërtime infrastrukturore në Garnizonin stërvitor Pajet, Bizë”, buxheti u realizua në masën 53%. Në realizimin e buxhetit të planifikuar ndikuan negativisht kushtet atmosferike, duke sjellë mosrealizim të zërave të punimeve të përcaktuara në grafikun e punimeve, të parashikuara për realizim në vitin 2024. Fondet e ngelura pa realizuar sipas kushteve të kontratës, janë planifikuar për buxhetim dhe realizim gjatë vitit 2025, duke krijuar mundësinë e likuidimit të detyrimeve kontraktuale.
- Projekti “TVSH për objektet ndërtimore”, buxheti u realizua në masën 44%. Në këtë projekt u likuiduan të gjitha detyrimet e vlerës së TVSH-së, sipas situacioneve të punimeve të paraqitura për ndërtimin e objekteve tip tunel, sipas marrëveshjes kontraktuale.
- Sisteme Nënujore Autonome për kërkimin e minave detare për operacionet VSWMCM (Autonomous underwater vehicle) dhe pajisje për identifikimin dhe klasifikimin e minave detare,

Sonar scanner. Ky projekt nuk është realizuar gjatë vitit 2024, pasi nuk u arrit përfundimi i hartimit të projektit teknik nga Drejtoria e Modernizimit në MM.

- Ndërtimi i mureve përforcuese të Komandës së Kepit të Palit (prona 240, godina nr. 34), dhe rikonstruksion i pjesshëm i godinës. Rikonstruksion i objektit dykatësh në Kepin e Palit. Ky projekt nuk u realizua për vitin 2024, pasi procedura e prokurimit nga OBP, përfundoi dhe u vu në dispozicion për lidhje kontrate në fund të vitit 2024.
- Rikonstruksion i godinës nr.1 të KFD (Përmirësimi i sistemit të ajrim kondicionimit dhe hidroizolimit, sistemi rrufepritës), projekti nuk është realizuar gjatë vitit 2024, pasi nuk u arrit përfundimi i hartimit të projekt preventivit nga IGJIU-ja.
- Rikonstruksion i godinës Nr.1 të KFD (Përmirësimi i sistemit të ajrim kondicionimit dhe hidroizolimit, sistemi rrufepritës. Projekti nuk është realizuar gjatë vitit 2024, pasi nuk u arrit përfundimi i hartimit të projekt preventivit nga IGJIU-ja.

Gjatë vitit 2024 nuk janë krijuar detyrime të prapambetura në projektet e investimeve.

Disa nga projektet e investimit që kanë përfunduar gjatë vitit 2024, mund të përmendim:

Në projektet e modernizimit:

Në projektin “Blerje armatim-municion, makineri e pajisje”.

- Pjesë këmbimi për mitralozat e lehtë, të mesëm (MSS);
- Blerje pjesë këmbimi për mortajat;
- Pajisje individuale të avancuara luftimi për ROS dhe GBKL;
- Kompletim me armatim individual dhe kolektiv për strukturat e FT-së;
- Kompletim me pajisje radio-komunikimi, për kontingjentet jashtë vendit.

Kompletimi me këto pajisje ka përmirësuar ndjeshëm rritjen e kapaciteteve operacionale/resurseve të nevojshme për përballimin e situatave në kohë paqe, elementet e ruajtjes dhe të sigurisë së personelit pjesëmarrës në stërvitje dhe transmetimit të informacionit të sigurt në përmbushjen e misionit, detyrave e objektivave të përcaktuara në dokumentet strategjike në fushën e mbrojtjes.

Me këtë investim u arritën rezultatet e synuara:

- Rritja e gatishmërisë operacionale të Forcave Detare dhe përmbushjen e misionit kushtetues dhe objektivave të NATO-s;
- Përmirësimi i elementeve të ruajtjes dhe të sigurisë të Poligonit Kombëtar Pajet Bizë;
- U pasurua me literaturë biblioteka e AFA, duke siguruar literaturën e nevojshme për studentët dhe kursantët dhe rritja e efikasitetit në procesin e të mësuarit;
- U ngrit sistemi informatik për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, duke ulur kohën e përpunimit të informacionit dhe rritja e saktësisë së tij.

Gjatë vitit 2024 ka pasur mospërputhje mes ecures fizike të projekteve me planin e financimit, për arsye prokurimi dhe problematikave me lejet zhvillimore mjedisore dhe miratimit të projekteve nga IGJIU-ja.

Gjatë vitit 2024 investimet e zbatuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë paraqitur problematika, të cilat kanë të bëjnë me ecurinë fizike dhe procedurale të tyre. Vonesa të cilat kanë ndikuar në realizimin në një nivel më të ulët të investimeve dhe rritjen e detyrimit për t'u financuar në vitin pasardhës, situatë

e cila ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në pakësimin e fondeve në dispozicion për financimin e projekteve të reja.

Nuk janë krijuar detyrime të prapambetura për projektet e investimeve.

Disa nga projektet e investimit që kanë përfunduar në vitin 2024, mund të përmendim:

Ndërtimin/rikonstruksionin:

U rikonstruktuan 9270 m² ambiente ekzistuese;

U sistemuan dhe u krijuan ambiente të reja funksionale 8361 m².

- Rikonstruksion i ambienteve të brendshme dhe të jashtme sportive në Repartin Ushtarak nr. 1001 (viti i fillimit të projektit 2022 – viti i përfundimit 2024”).
- Rikonstruksion i objekti 4,8 dhe 15 Reparti Ushtarak nr. 1030 (viti i fillimit i projektit 2023- viti i përfundimit 2024).
- Rikonstruksion objekte ndërtimore Reparti Ushtarak nr. 1040 (viti i fillimit i projektit 2023 - viti i përfundimit 2024);
- Sistemim i rrjetit rrugor dhe sheshit kryesor Reparti Ushtarak nr.1010 (viti i fillimit i projektit 2023 - viti i përfundimit 2024);
- U kryen punime nëntokë dhe mbi tokë në sipërfaqen 17,462 m³, për godinën e re të fakultetit dhe mensës në Kampusin të ri AFA-së;
- Investimet infrastrukturore në disa bashki të vendit, si p.sh.: Rehabilitim emergjent i përroit të Gjerezës te Fresku L=620 m, masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfaqës, pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavijë, Përforcim terreni nga rrëshqitja në zonën e NJ. A Nr. 2, Nr. 4, Ishëm, Sistemim përroi, fshati Dobranj, Mbrojtja e lagjes Nonëve nga gërryerja e përroit të Gostimës, fshati Polis Valë, Nj. A Shushicë, ndërtim muri mbajtës në shkarjen e fshatit Krane, Ndërrhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit, Rezervuar i Gjonçit, Prita malore në fshatrat Mësiçkë, Taç Poshtë, Rehabilitim i digës së rezervuarit Gjokaj 1 etj.

Projektet e përfunduara arritën rezultatet e pritshme. Investimi ndikoi në rritjen e gatishmërisë operacionale të Forcave Tokësore dhe kushteve për rritjen e përqindjes së personelit të trajnuar për mbushjen e misionit kushtetues dhe objektivave të NATO-s.

Me këto investim u arritën rezultatet e synuara:

U sistemuan dhe u krijuan ambiente të reja funksionale 8361 m²;

U përmirësuan kushtet e punës për shumë punonjës, duke krijuar ambiente të reja sipas parametrave bashkëkohore të BE-së;

U përmirësua infrastruktura hardware dhe software;

U likuiduan detyrimet e përcaktuara në kontratat e projekteve me financim të huaj.

U përmirësua infrastruktura ekzistuese;

U sistemuan dhe u krijuan ambiente të reja funksionale 8361 m²;

U likuiduan detyrimet e përcaktuara në kontratat e projekteve me financim të huaj;

U blenë software për ngritjen e një sistemi informatik për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë.

INVESTIMET E HUAJA.

- Shpenzime kapitale me financim të huaj, në shumën 12,212,050 mijë lekë. Krahësuar të dhënat në Sistemin Informatik Financiar Qeveritar (SIFQ) me vlerat e pasqyruara në ligjin e buxhetit 97/2023, “Për buxhetin 2024”, evidentohet ndryshim (pakësim) në “Shpenzimet kapitale me financim të huaj”. Këto projekte nuk kanë plan të miratuar dhe nuk raportohen nëpërmjet sistemit të thesarit, në programin “Forcat e Luftimit” dhe “Emergjencat Civile”.

SHPENZIMET E REALIZUARA NGA TË ARDHURAT JASHTË PLANIT LIMIT (KAP. 6)

Në 000 lekë

GR	TIT	KAP	Fakti sipas sistemit					
			600	601	602	604	605	606
17	Arsimimi Ushtarak	06		61	3,135			685
17	Mbështetje për Shëndetësinë	06	7,990		469			
17	Emergjencat Civile	06			4,200			
TOTALI			7,990	61	7,805	0	0	685

- Në total shpenzimet e realizuara nga të ardhurat nga programi “**Arsimimi Ushtarak**”, jashtë planit limit për vitin 2024 janë në shumën **16,541 mijë lekë** të detajuara për artikujt ekonomikë përkatës, si më poshtë:
- Në artikullin 606 dhe 601 “Shpenzime personeli” në shumën 8,051 mijë lekë, janë realizuar pagesa për punonjësit me kontratë dhe janë paguar pedagogë me kohë të pjesshme.
- Në artikullin 602 “Mallra e shërbime të tjera”, në shumën 7,805 mijë lekë, janë realizuar pagesat:
Likuidimin e detyrimit të prapambetur për udhëheqjen e doktoraturave;
Blerje materiale mjekësore.
- Në artikullin 606 “Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët”, në shumën 685 mijë lekë, janë realizuar pagesat e pagave për pedagogët me kohë të pjesshme.

Për artikullin 602 “Mallra e Shërbime” u mbështetën me fonde financiare për:

- U përballuan shpenzimet për ushtarakët aktivë që shërbejnë në shtabe të NATO-s dhe atashetë ushtarakë;
- U ble karburanti për Forcat e Armatosura;
- U krye furnizimi dhe shërbimi me ushqim për mencent dhe kompensimin financiar të ushqimit;
- U riparuan dhe u mirëmbajtën helikopterët për Komandën e Forcës Ajrore;
- U trajnuan pilotët dhe personeli që menaxhon avionët pa pilot të Forcës Ajrore;
- U riparuan dhe u mirëmbajtën anijet për Komandën e Forcës Detare;
- Shpenzime për misionet paqeruajtëse ndërkombëtare;

- U përballuan shpenzimet për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura në udhëtime brenda dhe jashtë vendit;
- U përballuan shpenzimet për stërvitje të përbashkëta etj.;
- U trajtuan rreth 95,000 urgjenca/të shtruar te spitali i traumës, si dhe raste ambulatorë;
- U mbuluan shpenzimet për emergjencat civile nëpërmjet zërit “Ndërhyrje infrastrukturore për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe blerje pajisje për mbrojtjen civile;
- U trajtuan si kategori përfitues të pensioneve suplementare të ushtarakëve **22,000 persona**.

NDRYSHIMET NË BUXHET

Ndryshimet në buxhet për vitin 2024 janë:

Në total ministrie, ndryshimi i buxhetit për këtë periudhë paraqitet me ulje në vlerën **11,226,628** mijë lekë në krahasim me buxhetin fillestar, sipas artikujve buxhetorë në mijë lekë:

	LLOGARIA EKONOMIKE	PLANI FILLESTAR	PLANI ME NDRYSHIME	Shpenzime faktike	MBETJE	% e Realizimit	NDRYSHIME
TOTAL MINISTRIA E MBROJTJES	600	8,284,910	8,522,610	8,488,505	34,105	100	237,700
	601	1,210,906	1,481,879	1,460,354	21,524	99	270,973
	602	7,121,150	7,084,856	6,750,921	333,936	95	(36,294)
	603	0	0	0	0	0	-
	604	6,000,000	6,315,000	6,127,240	187,760	97	315,000
	605	293,424	478,320	476,198	2,122	100	184,896
	606	528,936	679,283	624,839	54,445	92	150,347
	231	12,687,000	12,549,800	10,153,292	2,396,508	81	(137,200)
	231/2	12,212,050	0	0	0	0	(12,212,050)
	TOTALI	48,338,376	37,111,748	34,081,349	3,030,399	92	(11,226,628)

Shkresat në të cilat pasqyrohet ndryshimi i buxhetit për vitin 2024 janë:

- Mbi zbatimin e VKM nr. 422, datë 26.06.2024 dhe VKM nr. 424, datë 26.06.2024, në shumën 113,000 mijë lekë.
- Në artikullin 606 Transferta familjare”, bazuar në shkresën e Ministrisë së Financave nr. 2655/1 prot., datë 12.03.2024, “Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2024”, në shumën 30,900 mijë lekë.
- Mbi zbatimin e VKM nr.300, datë 17.05.2024, në shumën 1,504,000 mijë lekë.
- Akti Normativ nr.3, datë 28.08.2024 dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.11696/71, datë17.09.24, shkresës së Ministrisë së Financave nr.12100/1, datë.30.0924.
- Shkresës së Ministrisë së Financave nr.15628/1, datë.15.11.2024.
- Akti Normativ nr.5, datë 19.12.2024, shkresës së Ministrisë së Financave nr.17609/13, datë 15.11.24, shkresës së Ministrisë së Financave nr.13902/1, datë 24.10.2024.
- VKM nr. 582, datë18.09.2024, shkresës së Ministrisë së Financave nr.13358/1, datë11.10.2024.
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.13031/1 prot.,datë 11.10.2024.
- VKM nr. 846, datë 26.12.2024 dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.17605/53 prot., datë15.01.2025.
- Akti Normativ nr.3, datë 28.08.2024”, shkresës së Ministrisë së Financave nr, 11696/152 prot., datë 07.10.2024
- Shkresa e Ministrisë së Financave nr.15628/3 prot., datë 02.12.2024.

- Akti Normativ nr.5, datë 19.12.2024” dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr.17526/82 prot., datë 31.12.2024.
- Akti Normativ nr. 3, datë 28.08.2024, si dhe shkresës së Ministrisë së Financave nr. 11696/152 prot., datë 07.10.2024.
- Pakësimi në shpenzime kapitale me financim të huaj, në shumën 12,212,050 mijë lekë.

DISA PROBLEMATIKA NË LIDHJE ME GJENERIMIN E RAPORTEVE NGA MODULI “BPPM”, NË SISTEMIN “AFMIS”

Në sistemin AFMIS nga ana e EMP-ve janë hedhur të dhënat faktike për treguesit e performancës në nivel qëllimi dhe objektivi të politikës, si dhe sasitë faktike të produkteve për secilin program buxhetor. Nga monitorimi i produkteve u vërejtën disa mospërputhje në emërtim dhe vlerë, midis sistemit AFMIS raporti nr. 16 “Output Monitoring Data” dhe atij SIFQ në portofolin 00 (Raporte dhe anekse), në aneksin nr.3 “Raporti i performancës së produkteve”, si më poshtë:

Në projektin “Modernizimi i Forcës Tokësore”.

Kodi i projektit 18AY909 në sistemin AFMIS, pasqyrohet me emërtimin e saktë në zbatim “Ndërtim objekteve dhe punime për rikonstruksione godinash në KFT Zall-Herr”, ndërsa në SIFQ, në portofolin 00 (Raporte dhe anekse), ka emërtesën “Ndërtim parku B për mjetet e blinduara”.

Nuk pasqyrohen në aneksin 16 “Output Monitoring Data” në Programin Buxhetor “Forcat e Luftimit”, si më poshtë:

Në projektet e modernizimit.

Në projektin “Modernizimi i Forcës Tokësore”

Projekti “Tvsh për objektet ndërtimore” pasqyrohet në SIFQ, por jo në rubrikën “Raporte dhe anekse” në sistemin AFMIS (Plan 17,300 mijë lekë dhe realizim 7 684 mijë lekë).

Në projektin “Modernizimi i Forcës Detare”

Projekti “Rinovimi dhe përmirësimi teknologjik i sistemit SIVHD....”, pasqyrohet në SIFQ, por jo në sistemin AFMIS (plan 598,289 mijë lekë dhe realizim 598 289 mijë lekë).

Në projektin “Modernizimi i Forcës Ajrore”

Projekti “Kapaciteti i avionëve pa pilot të armatosur/Dron UAV së bashku me sistemet e komandim-kontrollit” (Plan 1 914,759 mijë lekë dhe fakt 1 914 760 mijë lekë).

Projekti “Krijimi i kapitalit fillestar KAYO” (plan 150,000 mijë lekë dhe fakt 150,000 mijë lekë). Ky projekt nuk pasqyrohet edhe në aneksin 3.

Në projektin “Modernizimi i Forcës Ajrore”

Kodi i projektit 21AC101, në sistemin AFMIS, nuk është produkt i përfshirë në programin buxhetor “Forcat e Luftimit” dhe nuk pasqyrohet si emërim dhe si vlerë buxhetimi.

Sa më sipër, raportet e monitorimit u konsoliduan sipas të dhënave faktike të rakorduara me Degët e Thesarit. Luhatjet e kostos për njësi faktike me koston e planit të rishikuar janë në sistemin AFMIS, kur është bërë shtesa e fondeve me VKM-të e rritjes së pagave etj., është reflektuar shtesa e fondeve pa reflektuar edhe ndryshimin e sasisë së planifikuar të rishikuar.

TË ARDHURAT JASHTË PLANIT LIMIT (KAP. 6)

Të ardhurat jashtë planit limit për vitin 2024 janë në shumën **36,865 mijë lekë**. Të analizuara sipas programeve në mijë lekë:

Programi	TIT	KAP	Fakti viti 2024							
			600	601	602	604	605	606	231	
Mbështetja e Luftimit	02150	06							3,575	3,575
Forcat e Luftimit	02120	06							13,467	13,467
Arsimimi Ushtarak	09430	06		61	3,135	0	0	685		3,882
Mbështetje për Shëndetësinë	07340	06	7,990		469	0	0		3,282	11,742
Emergjencat Civile	10910	06			4,200	0	0			4,200
TOTALI			7,990	61	7,805	0	0	685	20,324	36,865

INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA TË KRIJUARA RISHTAZI

Detyrimet e prapambetura e të krijuar rishtazi për periudhën, të raportuara nga njësitë shpenzuese të Ministrisë së Mbrojtjes, janë në vlerën rreth **400,737 mijë lekë**.

Theksojmë se këto detyrime i përkasin detyrimeve të prapambetura të trashëguara ndër vite kryesisht nga ish-Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile. Nga MM-ja janë bërë kërkesat përkatëse në Programin Buxhetor Afatmesëm, por, referuar analizave të realizimit të pritshëm të buxhetit, do të shihet mundësia e rialokimit të fondeve midis artikujve, me qëllim likuidimin total të detyrimeve të prapambetura.

Në bazë të vlerësimit të të dhënave të realizimit të shpenzimeve buxhetore gjatë çdo muaji, është ndjekur sistematikisht dhe me përgjegjësi menaxhimi i fondeve buxhetore.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.